



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 129/8 Prot.

Tiranë, më 22 .04 .2024

V E N D I M

Nr. 103, Datë 22 .04 .2024

Bazuar në nenin 33/11, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në ndryshuar, është regjistruar ankesa nr. 06, datë 23.01.2024¹, e bërë nga z. A.B² kundër Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”, “ngjyrës”, “etnisë” dhe “shtetësisë”.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gjerat “a”, “ç”, nenit 33, pikat 11-15 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën dhe i janë ofruar mundësitë, që të jepte shpjegime dhe dokumentacion për ankesën sipërcituar, në mënyrë që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kishte mundësi të shqyrtonte këtë ankesë. Komisioneri konstaton se Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me dijeninë e plotë nuk ka ofruar bashkëpunim dhe nuk ka dhënë informacionin dhe dokumentet e kërkuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në vijim të procedurave të shqyrtimit të çështjes, me shkresat: nr. 129/1, datë 07.02.2024 dhe nr. 129/2, datë 19.03.2024, Komisioneri i është drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, duke kërkuar informacion lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

¹ Ankesa është plotësuar me e-mail-in datë 01.02.2024.

² Referuar pasaportës nr. Z3195292, A.B, është shtetas i Republikës së Indisë.

Në vijim, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, pavarësisht faktit që ka marrë dijeni 2 (dy) herë, lidhur me shkresat e sipërcituara, nuk ka depozituar asnjë dokument apo parashtrim lidhur me sa ka kërkuar Komisioneri, në kuadër të shqyrtimit të ankesës në fjalë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në pamundësi të një informacioni të detajuar dhe verifikimit të dokumentacionit të kërkuar, është vënë në situatën e pamundësisë për të arritur në konkluzionin mbi trajtimin e pafavorshëm të shtetasit A.B.

Në këtë kuadër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në vijim të shqyrtimit të çështjes, me Vendimin nr. 96, datë 12.04.2024, ka dënuar me gjobë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për mosdhënien e informacionit të nevojshëm për shqyrtimin e çështjes, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Me shkresën nr. 1980/1, datë 18.04.2024, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka dërguar pranë Komisionerit, informacionin e kërkuar sipas Vendimit nr. 96, datë 12.04.2024.

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 33/11, “..... Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”, Komisioneri arrin në përfundimin se ka në dispozicion informacionin e kërkuar për të vazhduar shqyrtimin e çështjes.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 33/11 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e Vendimit nr. 96, datë 12.04.2024.
2. Vazhdimin e procedurës së shqyrtimit të ankesës nr. 06, datë 23.01.2024, të A.B.
3. Të njoftohen palët për këtë vendim.

KOMISIONERI

Robert GAJDA